



THE EUROPEAN UNION'S CROSS BORDER  
COOPERATION PROGRAM

**Project:**  
**CROSS BORDER FIRESHIELD**

### **Nënshkrimi i Marrëveshjes për Partneritet në kuadër të projektit “Fireshield”**

Në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar të Bashkimit Evropian, Maqedonia e Veriut – Shqipëri (IPA II) i financuar nga projekti CROSS BORDER FIRESHIELD, tre komuna nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria do të zhvillojnë dhe vënë në praktikë një plan të përbashkët të menaxhimit të rrezikut për mbrojtjen nga zjarri, ku Komuna e Vrapçishtit dhe Komunës së Bogovinës sipas Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal do të themelojnë një departament të përbashkët për mbrojtje nga zjarri. Të premtën, me datë 4 mars 2022, në mjediset e Komunës Vrapçisht u mbajt takimi fillestar i projektit, gjatë të cilit përfaqësues nga secili përfitues i projektit duke përfshirë z. Isen Shabani kryetarin e komunës së Vrapçishtit, z. Z. Besnik Emshi Kryetar i Komunës së Bogovinës dhe motra Camilla Maenza nga CARITAS Jug i Shqipërisë së bashku me ekipin e menaxhimit të projektit patën prezantimin hyrës të partnerit dhe prezantimin e përmbledhjes së projektit.

Si pjesë e takimit fillestar, përfituesit e projektit nënshkruan një Marrëveshje Partneriteti dhe vendosën për përbërjen e Komitetit Drejtues të projektit. Menaxheri i projektit të FIRESHIELD dhe koordinatorët e projektit prezantuan Planin e Zbatimit të Projektit dhe diskutuan hapat fillestarë për përgatitjen e Planit të Komunikimit të projektit.

Ky projekt financohet me thirrjen IPA II, CBC, Europe Aid/170339/DD/ACT/MK



Funded by  
the European Union

Implemented by:



Caritasi i Shqipërisë së Jugut  
Cerrik - Ferme




THE EUROPEAN UNION'S CROSS BORDER COOPERATION PROGRAM



Funded by the European Union

Implemented by:



Caritasi i Shqipërisë së Jugut  
Cerrik - Ferme